

PLANI I INTEGRITETIT

PËR

IGJIU

2022-2025

2023, Tiranë

Përmbajtja

1. PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

- 1.1 Përshkrim i shkurtër për institucionin
- 1.2 Baza Ligjore dhe materiale referuese
- 1.3 Ngritja e Grupit të Punës
- 1.4 QËLLIMI
- 1.5 **Plani i Integritetit për IGJIU**

2. RISQET DHE FAKTORËT E RISQEVE

- 2.1 Veprimtaria brenda institucionit

3. PLANI I VEPRIMIT

- 1.1 Përmbledhje
- 1.2 Monitorimi

1. PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT

1.1 Përshkrim i shkurtër për institucionin

Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake i cili ushtron veprimtarinë e tij në bazë të ligjit nr.8907, datë 6.6.2002 “Për funksionimin e Institutit Gjeografik të Shqipërisë”, i ndryshuar,

Misioni i institucionit përfshin mbështetjen gjeografike e veprimeve ushtarake të Forcave të Armatosura, kryerja e veprimtarisë në fushat e gjeodezisë, hartografisë dhe fotogrametrisë, në mbështetje të remote-sensing si dhe mbështetje të kërkesave për studim, projektim, standartizim, çertifikim të të gjitha objekteve ekzistuese dhe atyre të prespektivës.

IGJIU është institucion vartës i Ministrisë së Mbrojtjes. Kryesohet nga Drejtori i IGJIU-së, dhe ka në përbërje 9 (nëntë) sektorë.

1.2 Baza ligjore dhe materialet referuese

1. Ligji nr. 64/2014, datë 26.06.2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të FA të RSH” i ndryshuar
2. Ligji nr.173/2014, datë 18.12.2014 "Për disiplinën ushtarake në Forcat e Armatosura të RSH.
3. Kodi i punës
4. Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar.
5. Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” i ndryshuar,
6. Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik”,
7. Matrica e aktiviteteve kryesore, aktivitete të miratuara nga MM

1.3 Ngritja e Grupit të Punës

Referuar Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nr.516, datë 19.04.2022 “Për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes 2022-2025 dhe planit të veprimit 2022-2023

Plani i Integritetit 2022-2025 është dokumenti për të kontribuar në parandalimin dhe luftën kundër rreziqeve të mundshme të korrupsionit në këtë institucion. Plani ka identifikuar rreziqe të integritetit në fushat e mëposhtme:

1. Fusha e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm;
2. Fusha e menaxhimit arkivor.

1.4 QËLLIMI

Qëllimi kryesor i Planit të Integritetit të IGJIU-së 2022-2025 është të forcojë integritetin dhe kulturën kundër korrupsionit.

Integriteti konsiston në përmbushjen e disa karakteristikave në kuadër të luftës kundër korrupsionit, disa nga format e shkeljes së integritetit janë:

- Përvetësimi, shpërdorimi, devijimi i fondeve publike;
- Trajtimi i qytetarëve në mënyrë të pabarabartë ose të pa drejtë;
- Neglizhenca.

Risku i integritetit përbën efektin e pasigurisë për objektivat organizative të institucionit, të shkaktuar nga korrupsioni dhe shkeljet e integritetit, si dhe lidhet me mundësinë e përditshme të ndodhjes së një ngjarjeje me ndikim në integritetin e institucionit.

Qëllimi i vlerësimit të riskut është identifikimi i risqeve “të sjelljes” brenda institucionit, që kompromenton aftësinë e tij për të kryer funksionin e shërbimit publik, në mënyrë të paanshme dhe të përgjegjshme.

Roli i rëndësishëm që ka Plani i Integritetit përfshin përmirësimin e një sistemi efektiv të menaxhimit të integritetit në institucion, transparencës në institucion, si dhe planifikimin e menaxhimit të riskut të integritetit.

1.5 Plani i Integritetit për IGJIU

Misioni i hartimit të këtij akti është përfshirja e analizës sistematike të riskut, sipas fushës së përgjegjësisë së institucionit, llogaridhënies dhe transparencës së institucionit.

Hartimi i dokumentit është kryer nga Grupi i Punës, mbështetur në detyrat kryesore që realizohen.

Grupi i Punës i kushtoi vëmendje aspekteve ligjore dhe rregullatore të institucionit, duke u bazuar në çështje të tilla si analiza, mbledhje informacionesh dhe koordinime.

2. RREZIQET E INTEGRITETIT DHE KORRUPSIONIT

- ***Menaxhimi i efektshëm i fondeve buxhetore të IGJIU-së***
- Mosrealizimi në kohë, i procedurave elektronike të prokurimit të fondeve buxhetore (kryesisht për shpenzimet operative dhe blerjet me vlera të vogla)
- Moslikujdimi në kohë nga ana e institucionit dhe subjekteve ndaj IGJIU-se
- Pagesa të rreme ose të çrregullta
- Menaxhimi i dhënjes së shërbimit ndaj qytetarëve dhe administrimi i aktiveve

2.1 Veprimtaria brenda institucionit

Bazuar në strukturën organizative aktuale, është arritur të formulohet një kuadër i përgjithshëm rregullator, sipas përgjegjësisë dhe funksioneve që mbulojnë sektorët e këtij institucioni. Analiza e detajuar është kryer për fushat e veprimtarisë që kërkonin vlerësim për shkak të ekspozimit ndaj risqeve.

SEKTORI I MBËSHTETJES

Detyrat e këtij Sektori lidhen me mbështetjen e veprimtarisë së IGJIU-së, me qëllim mirëadministrimin e burimeve njerëzore, aseteve dhe shërbimeve, si dhe garantimin e burimeve të nevojshme financiare.

Në lidhje me *veprimtaritë financiare*, nëpunësit mbajnë në konsideratë zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, për planifikimin e fondeve buxhetore të nevojshme për realizimin e aktiviteteve dhe objektivave të programuara në buxhetin e IGJIU-së. Po kështu, kontabilizimi i të gjitha veprimeve financiare, identifikimin e risqeve me qëllim forcimin e disiplinës financiare për parandalimin e akumulimit të detyrimeve financiare eventuale në të ardhmen.

Nga analiza e kryer, nuk rezultojnë risqe të lidhura me funksionet që kryen ky sektor, pasi nga etapa e planifikimit deri në përfundim (realizim), kryhet monitorimi nga struktura të vecanta të krijuara në MM, analiza mujore, rakordime mujore medegën e thesarit dhe MM, që përcaktojnë rregullat e procedurat mbi monitorimin e fondeve buxhetore rritja e llogaridhënies, transparencës dhe nivelit të kontrollit mbi përdorimin e fondeve buxhetore.

Për sa i përket *menaxhimit të investimeve publike*, sërish vlerësohet se nuk ka një risk të drejtpërdrejtë gjatë ushtrimit të funksioneve nga nëpunësit, pasi të gjitha procedurat ndjekën edhe nga grupe ose struktura të tjera të MM.

Burimet njerëzore të IGJIU-së menaxhohen nga një specialist, i cili ndjek rekrutimet dhe organizimin strukturor, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm organizativ dhe funksional. Konsiderohet mjaft e rëndësishme ndjekja dhe plotësimi i kërkesave ligjore të dosjeve personale të nëpunësve, duke kërkuar në mënyrë periodike pasqyrimi në dosje i vlerësimit të punës së tyre nga Shefat e sektoreve

Gjithashtu, specialisti që mbulon këtë fushë, bënë përpjekje të vazhdueshme në lidhje me:

- Njohjen e Rregullores së Brendshme nga të gjithë nëpunësit;
- Sigurimin e dhënies së mundësisë për çdo nëpunës, për të marrë pjesë në trajnime;
- Ruajtjen e parimit bazë ligjor të konfliktit të interesit, me qëllim parandalimin e tij në zbatim të legjislacionit në fuqi;
- Azhornimi i Librit Themeltar të punonjësve civilë dhe ushtarakë për lëvizjet në detyrë dhe daljen në pension,
- Evidentimi i personelit të IGJIU-së pa çertifikatë sigurie dhe përgatitja e dokumentacionit të domosdoshëm për paisje.

Në lidhje me *administrimin dhe arkivimin e dokumentacionit* që hyn në institucion apo që shpërndahet sipas rastit në drejtori brenda IGJIU-së, konstatohet se në mënyrë sistematike menaxhohen regjistra, në të cilat reflektohet protokollimi dhe veprimtaria e institucionit, në drejtim të shkresave hyrëse dhe dalëse, si dhe krijimit të fondit arkivor, si dhe herë pas herë kontrollohet nga struktura të MM.

IT, menaxhohet nga nje specialist, i cili identifikon dhe rekomandon masat e mundshme për zvogëlimin dhe parandalimin e korrupsionit në sektorin e teknologjisë informative. Specilaisti në bashkëpunim me specialist të ASNI, bëjnë përpjekje të vazhdueshme në lidhje me:

1. Ndalimi i Aksesit së përdorimit: I cili mund të shkaktojë shfrytëzimin e informacionit për qëllime të korrupsionit.
2. Kërcënimi i Sigurisë Informatike: Korrupsioni mund të ndodhë nëpërmjet sulmeve të kërcënimeve të sigurisë informatike, duke infektuar sistemet me softuer të dëmshëm që vjedh informacion.

Deri tani sistemin të cilin menaxhojmë kontrollohet, ruhet dhe monitorohet dhe nga serverat e SHPFA-së dhe ASNI.

Për fushat e trajtuara më lart, nuk është identifikuar risk integriteti.

Spektori i Kordinimit

Menaxhimi i ndjekjes së çështjeve gjyqësore dhe shqyrtimit të ankimit administrativ ka siguruar që të ofrojë mbrojtjen juridike të institucionit në instancat e sistemit gjyqësor, duke ruajtur profesionalizmin, nëpërmjet përgatitjes së mbrojtjes menjëherë pas njoftimit të kërkesë padisë nga gjykata dhe evitimit të kontaktit të mundshëm me palët ndërgjyqëse, që mund të këtë ndikim në përfaqësimin e institucionit. Gjithashtu, vihet re se nuk paraqitet risk për trajtim të diferencuar të ankimeve apo shqyrtimit të praktikave gjyqësore/përmbarimore, duke qenë se veprohet brenda afateve të vendosura si kërkesa ligjore.

Për sa i përket *procedurave të prokurimit publik*, vlerësohet e rëndësishme që nëpunësit të tregojnë profesionalizëm veçanërisht për respektimin e kërkesave ligjore lidhur me këtë fushë, si dhe të parandalojnë rastet e konfliktit të interesit, që mund të konstatojnë gjatë punës së tyre në ndërveprim me operatorët ekonomikë.

Kordinimi dhe bashkëpunimi për kryerjen e aktiviteteve dhe takimeve që do të zhvillohen në IGJIU

Nuk është identifikuar risk integriteti.

Spektori MIA

- Menaxhohet nga shefi dhe 2 punonjës, të cilët ndjekin Menaxhimin dhe azhurnimin e Database-s me dokumentacionin teknik (harta, projekte) të prodhuara nga IGJIU. Punonjësit mbajnë në konsiderat zbatimin e rregullave për ruajtjen dhe administrimin e aktiveve.
- Menaxhimi i dhënjes së shërbimit ndaj qytetarëve të ndryshëm me materiale hartografike, fotografike e topografike kundrejt tarifave dhe rregullave. Ky shërbim është një ndër shërbimet që ofrohet online, nëpërmjet sistemit SQDNE. Sistem i cili nuk ka risk integriteti pasi çdo veprim që nga kërkesa deri në marrjen e shërbimit të kërkuar kryhet nëpërmjet sistemit.(pa pasur kontakt me qytetarë)

Sektorët e tjerë të IGJIU-së.

Detyrat e Sektorëve mbështeten në arritjen e kapaciteteve me aftësitë bazë për realizimin e misionit dhe detyrave kryesore të IGIJU- së. Standartizimi i produkteve dhe shërbimit të ofruar në FA, përfundimi i ngritjes së Gjeodatabazës të vlefshme për sistemin e analizës së terrenit dhe në funksion të mbështetjes së FA, të kërkesave për studim, projektim, standartizim, çertifikim të të gjitha objekteve ekzistuese dhe atyre të prespektivës. Në lidhje me veprimtarinë nëpunësit mbajnë në konsideratë kërkesat e ardhura nga strukturat e FA-së.

2. PLANI I VEPRIMIT

2.1 Përmbledhje

Në përfundim të hartimit të Planit të Integritetit, me qëllim ruajtjen e integritetit të figurës së nëpunësit, ruajtjen e profesionalizmit, zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi në fushën e financave publike, burimeve njerëzore, arkivimit të dokumentacionit dhe me gjerë, Menaxhimi i dhënjes së shërbimit ndaj qytetarëve, përcaktohet se nëpunësit duhet të konsiderojnë që:

- 1) Të karakterizohen nga ndershmëria dhe përkushtimi në kryerjen e detyrave, duke zbatuar me rreptësi rregullat që normojnë disiplinën në punë;
- 2) Të shmangin sjellje të paqarta dhe të dyshimta apo çdo diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, kombësisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit të bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, ose për çdo shkak tjetër.
- 3) Të njihen personalisht me përshtatimin e punës që do të kryejnë sipas pozicionit, duke iu përmbytur përcaktimeve të tij;
- 4) Të mbajnë në konsideratë parimet bazë të veprimtarisë së institucionit;
- 5) Të mbajnë përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e veprimeve apo mosveprimeve gjatë ushtrimit të detyrës;
- 6) Të njihen me procedurat e sinjalizimit;
- 7) Të respektojnë dispozitat ligjore që rregullojnë konfidencialitetin, informimin publik, konsultimin publik dhe transparencën;
- 8) Të deklarojnë çdo rast të konfliktit të interesit;
- 9) Të mos kërkojnë apo të mos pranojnë dhurata, favore, pritje ose çfarëdo përfitimi tjetër, si dhe premtime për to, për veten, familjen, të afërmit, personat ose organizatat me të cilat kanë marrëdhënie, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanësinë e kryerjes së detyrës, apo janë ose duket sikur janë shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare.

2.2 Monitorimi

Monitorimi i ndjekjes së Planit të Integritetit apo zbatimit të rekomandimeve të dhëna do të kryhet periodikisht dhe përfshin aktivitete nga ana e nëpunësve të ngarkuar me këtë qëllim. Procesi synon të përcaktojë nëse është e nevojshme marrja e masave, nëse janë evidentuar ndryshime të risqeve, si dhe nëse ka kërkesa për rishikim.

Për proceset e detajuara të monitorimit, raportimit, konstatimit apo çështjeve të lidhura me to, do të angazhohet një ose disa nëpunës, të caktuar nga titullari, të cilët sipas rasteve: si shpenzime, masa disiplinore, hetime administrative, do të trajtohen rast pas rasti, nga struktura që ka në fushën e saj të përgjegjësisë çështjen në fjalë, ose do të përcillet praktika në strukturat e MM.